

të vet [Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze]. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin atë të gjallë. Trupi i Xhevxhetit u zbulua pas tërheqjes së forcave serbe më 25.09.1998 në pyll përmbi Prekaz të Epërm/Gornje Prekaze, dhe në drejtim të fshatit Lubavec/Ljubovac. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata B.M, FDH-31870; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ejup (Dibran) Behrami

(16.10.1955, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, korri-er në shkollë, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Nga ora 6:00, më 22.09.1998, në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze, u dëgjua zhurma e tankeve dhe makinave. Ejupi me një grup burrash u strehuan pranë përroskës së fshatit. Pas pak, ai me Fazli dhe Gani Fazliun shkuan në pyllin e quajtur *Mali i Fazlidemëve/Šuma Fazlidema*, ndërkaq, pas pak, vazhduan drejt lagjes *Deliu [Prekaz i Epërm/Gornje Prekaze]*. Por, forcat serbe i vërejtën dhe hapën zjarr drejt tyre. Ejupin e plagosën rëndë në këmbën e djathtë dhe në stomak. Ushtarët e UÇK-së i dhanë ndihmën e parë. Pas tri ditësh, e çuan te mjeku në Shipol/Šipolje [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica]. Megjithatë, gjendja shëndetësore e Ejupit po përkeqësohej për shkak të infeksionit të plagëve. Ka dhënë shpirt më 23.03.1999. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e Prekazit të Epërm/Gornje Prekaze.

Burimet: deklarata B.R, FDH-16635; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Fetije (Ferat) Bislimi

(28.03.1966, shqiptare nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica)

Para depërtimit të forcave serbe në Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze, më 22.09.1998, pjesa më madhe e familjes Bislimi e ka braktisur fshatin dhe u strehua në pyll. Në shtëpi ndenjën vetëm Fetija dhe axha Bislim. Fetija vuante nga problemet psikike. Nga ora 10:00, pjesëtarë të forcave serbe erdhën në afërsi të shtëpisë së tyre [Gornje Prekaze/Prekaz i Epërm]. Bislimi vendosi që të strehohet me Fetijen në ahur, i cili gjendej në

skaj të oborrit. Vetëm sa dolën nga shtëpia, pjesëtarët e forcave serbe nga kapia shtënën ndaj tyre. Fetijen e qëlluan dhe ajo ndërroi jetë në vend. Bislimi arriti të ikte me vrap. Kur u kthye më vonë, e gjeti shtëpinë e djegur. Zjarri e kishte kapluar edhe trupin e Fetijes në oborr. E fiku zjarrin dhe i mblodhi mbetjet mortore të Fetijes. I varrosi ato më 25.09.1998 në varrezat e fshatit

Burimet: deklarata B.B, FDH-16628; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; ICTY, IT-05-87 (S. Milošević), Ex.P.01434, FDH-33273.

Sokol (Fetah) Rama

(7.02.1915, shqiptar nga Prekazi i Epërm/Gornje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, tetë fëmijë)

Sokoli i moshëthyer jetonte në bashkësi familjare me djemtë Rrahmanin, Osmanin, Besimin dhe Ramën. Në datën 22.09.1998, së bashku me disa bashkëfshatarë të moshuar, u strehua në fshatin fqinj të Galicës/Galica, përderisa familjarët e tij kaluan në Klinën e Epërme/Gornja Klina. I fundit që e shihnte të gjallë ishte djali i vëllait, Bahriu. Sokoli i pati thënë se herët në mëngjes do të nisej për në fshatin e tij. Një ditë më vonë, një njeri nga Mikushnica/Mikušnica e ka gjetur trupin e pajetë të Sokolit në një fushë në **Prekazin e Epërm/Gornje Prekaze**. E kishin qëlluar me një plumb në kokë. Familjarët e kanë varrosur më 25.09.1998 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata B.R, FDH-16630; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256.

Muhamet (Rrahman) Idrizi

(1938, shqiptar nga Beçiqi/Bečić, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, bujk, tre fëmijë)

Muhameti jetonte me bashkëshorten Hamiden, djemtë Faikun, Vehbiun dhe Zeqirin, si dhe familjen e Faikut. Nga fundi i verës së vitit 1998, Muhameti e ka strehuar farefisën e bashkëshortes, që e kishte braktisur Laushen/Lauša. Forcat serbe e bombarduan fshatin [Beçiq/Bečić] më 21.09.1998. Për këtë arsye, Muhameti vendosi që familjen dhe refugjatët t'i strehonte